

Akademik Mark Krasniqi

PUSHKATIMI I MË SE 4 MIJË SHQIPTARËVE NË RRETHIN E PEJËS E TË GJAKOVËS

(Me rastin e 90-vjetorit të gjenocidit malazez në Dukagjin)

Çdo popull mban mend ditët dhe datat e shënuara të fitoreve dhe sukseve të ndryshme gjatë historisë së tij. Ato ditë përkujtohen dhe kremtohen me manifestime të shumta, me gëzim e hare, me krenari kombëtare dhe me mirënjohje e lavdata për ata njerëz të cilët dhanë kontributin e tyre në fusha të ndryshme për të mirën e popullit dhe të atdheut të vet. Ata që dhanë edhe jetën e tyre për idealet kombëtare, që u bënë kurban në altarin e atdheut, ata meritojnë mirënjohje e respekt të posaçëm dhe të përhershëm. Frytet e veprimtarëve të mëdhenj në planin kombëtar, qoftë me laps në dorë në lëmin e kulturës, ekonomisë, teknikës etj., qoftë me armë në dorë në fushën e betejës, ato fryte për të cilat ata nuk kishin ndonjë lëvërdi personale, i gëzojnë pasardhësit e tyre brez pas brezi dhe i pasurojnë më shumë me punën e tyre.

Në shqiptarët, para së gjithash shqiptarët jashtë kufirit shtetëror të Shqipërisë, kemi fare pak raste nga e kaluara jonë për t'iu gëzuar ditëve të shënuara. Kjo nuk vjen nga mosangazhimi i popullit tonë për lirinë dhe pavarësinë e tij, që ka qenë i gjallë gjatë gjithë historisë sonë, por ngase kushtet reale nuk kanë qenë në favorin tonë. Armiku ynë gjithmonë ka qenë numerikisht shumëfish më i madh dhe me përparësi tepër të madhe të mjeteve materiale, si me teknikën ushtarake, ashtu edhe me potencialin ekonomik.

Ne me këtë rast po e shënojmë një ditë zie, një vit tragjik për popullin tonë në Rrafshin e Dukagjinit, kur para 90 vjetësh ushtria e Malit të Zi i okupoj këto troje shekullore tonat dhe bëri gjenocid të tmerrshëm mbi popullsinë civile të pafajshme dhe të paarmatosur, duke e detyruar ta ndërrojë fenë dhe kombësinë e vet dhe të kalojë në fenë ortodokse e të pranojë kombësinë serbo-sllave. Ata që rezistonin pushkatoheshin pa

kurrfarë mëshire, pa kurrfarë gjykimi. Sipas të dhënave të burimit sllav, me atë rast në rrethin e Pejës e të Gjakovës u pushkatuan më se 4 mijë shqiptarë, kurse në rrethin e Plavës e të Gucisë 800 të tjerë. Janë persekutuar dhe ekzekutuar shqiptarët katolikë njësoj si shqiptarët myslimanë, sepse nuk ka qenë qëllimi i qeverisë së Malit të Zi vetëm t'i pagëzojë shqiptarët, por, para së gjithash, t'i sllavizojë, të zhduket kombi shqiptar nga trojet e veta mijëvjeçare. Kjo ka qenë politika serbo-malazeze gjatë gjithë shekujve të fqinjësisë sonë me ta, kjo politikë edhe sot është në rend dite dhe do të jetë e tillë edhe shumë kohë, deri sa të mos detyrohen këto vende të heqin dorë nga pretendimet imperialiste, zaptuese ndaj trojeve shqiptare. Rasti i viteve 1998-1999 duhet ta bindë botën demokratike evrop-amerikane se në këtë pjesë të Evropës nuk mund të ketë paqe të qëndrueshme nëse nuk veprohet në këtë mënyrë.

Tragjedinë e vitit 1913 e ka pësuar rëndë edhe Bajraku i Vranocit, përkatësisht Lugu i Baranit dhe shumë fshatra të tjera përreth tij. Bajraku, siç dihet, ka qenë organizatë ushtarake e formuar në kohën e sundimit turk në Ballkan, e organizuar në parimin gjeografik, përkatësisht në parimin territorial e jo fisnor. Në krye të Bajrakut të Vranocit ka qenë bajraktari, i cili ka pasur autorizime dhe përgjegjësi të madhe para popullit dhe para organeve të pushtetit në raste të caktuara. Shtëpia e Bajraktarit të Vranocit e ka fituar këtë titull në saje të autoritetit që gëzonte në popull, por edhe në saje të trimërisë që kishte treguar në fushën e mejdanit e të luftës në përgjithësi. Turqia e kishte formuar këtë bajrak për ta pasur krah në raste të tilla. Por Bajraku i Vranocit, si edhe shumë bajrakë të tjerë shqiptarë, më shpesh ka luftuar kundër pushtetit turk se në favor të tij.

Më 1913 qeveria malazeze u përpoq ta bindte Bajraktarin e Vranocit për ta pranuar dëshirën e kral Nikollës për t'u bashkuar me të me fis e me fe, me ortodoksizëm dhe sllavizëm, siç ishte ai. Kur Bajraktari e refuzoi me dinjitet këtë ofertë djallëzore për t'u bërë mik me armikun shekullor duke shkelur vlerat më të mëdha të njeriut – fenë e kombësinë, atëherë komandanti i xhandarmërisë Savë Batarja, i quajtur kështu nga shqiptarët për krimet ndaj tyre, i kërcënohet me egërsi Bajraktarit, duke e urdhëruar që brenda 3 ditësh ta mbledhë krejt Bajrakun dhe me burra, gra e fëmijë të shkojë në Pejë për t'u pagëzuar. Bajraktari i thotë se territori i Bajrakut të tij është i madh dhe nuk ka mundësi ta tubojë popullin për 3 ditë, por do ta bëjë këtë sa më shpejt që të jetë e mundur.

Ditën e caktuar niset kolona e gjatë për në Pejë, të cilën e priste te Ura e Gurit ushtria dhe policia malazeze e armatosur deri në dhëmbë, bashkë me popat, të cilët kishin mbushur kusitë me "ujë të bekuar", për t'i pagëzuar shqiptarët e gjorë. Rrugës për në Pejë, në fshatin Gorozhdec, u dalin serbët para për t'i detyruar të hynin në kishën e fshatit. Rapsodi

The first of these is the fact that the...
the second is the fact that the...
the third is the fact that the...

The fourth is the fact that the...
the fifth is the fact that the...
the sixth is the fact that the...

The seventh is the fact that the...
the eighth is the fact that the...
the ninth is the fact that the...

The tenth is the fact that the...
the eleventh is the fact that the...
the twelfth is the fact that the...

The thirteenth is the fact that the...
the fourteenth is the fact that the...
the fifteenth is the fact that the...

The sixteenth is the fact that the...
the seventeenth is the fact that the...
the eighteenth is the fact that the...

The nineteenth is the fact that the...
the twentieth is the fact that the...
the twenty-first is the fact that the...

The twenty-second is the fact that the...
the twenty-third is the fact that the...
the twenty-fourth is the fact that the...

The twenty-fifth is the fact that the...
the twenty-sixth is the fact that the...
the twenty-seventh is the fact that the...

The twenty-eighth is the fact that the...
the twenty-ninth is the fact that the...
the thirtieth is the fact that the...

The thirty-first is the fact that the...
the thirty-second is the fact that the...
the thirty-third is the fact that the...

The thirty-fourth is the fact that the...
the thirty-fifth is the fact that the...
the thirty-sixth is the fact that the...

Ne jemi dhe mbetemi shumë mirënjohës dhe shumë besnikë ndaj mikut tonë të madh e të sinqertë – ndaj Amerikës demokratike, e cila na shpëtoi nga gjenocidi serb, nga shfarosja e kombit tonë, që është qëllim shekullor i politikës serbo-malazeze.

Edhe në Konferencën e Paqes në Paris më 1919-1920, Fuqitë e Mëdha të Evropës vendosën ta copëtojnë kombin shqiptar dhe trojet e tij, duke ua dhuruar trojet e tij fqinjve tanë sllavë e grekë ortodoksë. Vetëm kryetari i Amerikës, i madhi Uilson, e kundërshtoi energjikisht këtë padrejtësi historike ndaj popullit të lashtë shqiptar, i cili ishte i pambrojtur dhe i pafuqishëm të luftonte kundër shteteve të mëdha. Presidenti Uilson në kundërshtimin e tij thonte se Amerika është kundër vendimit me të cilin dëmtohet populli i vogël shqiptar në favor të shtetit jugosllav, që është më i madh, më i fortë dhe i cili bën zhurmë të madhe për të fituar çka nuk i takon dhe çka nuk ka të drejtë.

Rrugën e ndershme të presidentit Uilson e ka ndjekur besnikërisht miku i madh i shqiptarëve dhe i drejtësisë e demokracisë, presidenti i nderuar Bill Klinton, me intervenimin e tij ushtarak në Kosovë më 1999, për çka populli shqiptar do t'i jetë mirënjohës përjetë.

Për përshpejtimin e intervenimit të NATO-s ka meritë të madhe rezistenca paqësore diplomatike dhjetëvjeçare, si edhe lufta e armatosur e kosovarëve për liri e pavarësi. Në këtë drejtim ka meritë të posaçme gjithashtu edhe miku ynë i nderuar, ambasadori zoti Uiliam Uokër, i cili më 1999 e alarmoi diplomacinë evro-amerikane për tmerrin e gjenocidit serb ndaj popullit shqiptar në Kosovë.

Shpresojmë se këtë rrugë të drejtë e të ndershme do ta ndjekë edhe presidenti i nderuar aktual i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zoti Bush dhe Qeveria e tij. Me ndihmën e Amerikës dhe të Aleatëve të saj evropianë do ta kemi Kosovën shtet të pavarur, sovran e demokratik me të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët e saj, pa dallim feje, rajoni e kombësie. Kosova e tillë do të jetë faktor i fuqishëm i stabilitetit, paqes dhe fqinjësisë së mirë në këtë pjesë të Evropës.

Statusi final i Kosovës mund të zgjidhet vetëm me pavarësimin e saj të plotë, siç është deklaruar me referendum në vitin 1991 popullsia shqiptare e cila përbën 90% të banorëve të përgjithshëm të Kosovës. Asnjë kombinim me çfarëdo bashkësie në kuadër të Serbisë, ose Jugosllavisë, nuk mund ta zgjidhë këtë problem, përkundrazi, ai do të komplikohet pa masë.

Serbia pretendon ta ketë Kosovën nën sundim se gjoja ajo paska qenë djep i kulturës dhe i shtetësisë serbe. Kjo nuk është aspak e vërtetë. Shteti serb i mesjetës është krijuar larg Kosovës, në krahinën serbe të quajtur Rashkë, kurse kishat mesjetare ortodokse në Kosovë janë ndërtuar në

kohën e Bizantit, shumë shekuj para se të shkelte këmba serbe në këto troje, të cilat gjithmonë kanë qenë etnikisht dhe historikisht shqiptare që nga ilirët e lashtë e deri më sot.

Më 1918 është formuar shteti jugosllav në të cilin kanë hyrë vullnetarisht sllavët që përbënin më vonë ish-Federatën Jugosllave, nga e cila tash u shkëputën me paqe, ose me luftë. Vetëm Kosova shqiptare u deytua me terror ushtarak të hyjë në atë shtet me 1918. Pra, Kosova është okupuar nga Serbia. Si mund t'i mohohet sot Kosovës që të jetë e lirë e sovranë? Si mund të tolerohet që sot Kosova të mbetet koloni e Serbisë në truallin e Evropës? Që Serbia të jetë zot në shtëpinë e shqiptarëve? Me një vendim të tillë të padrejtë shqiptarët kurrë nuk do të pajtohen, me asnjë çmim.

Po, Kosova është vetëm pjesë e problemit të popullit shqiptar të copëtuar e të ndarë në pesë shtete. Në realitet ky është problemi më i madh jo vetëm në Ballkan, por në mbarë Evropën, i cili duhet të zgjidhet konform zgjidhjes për të gjithë popujt e tjerë në Ballkan qysh në shekullin nëntëmbëdhjetë.

Faktori ndërkombëtar i vendosjes duhet ta marrë me shumë seriozitet këtë problem. Shpresojmë se diplomacia bashkëkohore evro-amerikane nuk do ta ndjekë rrugën e padrejtësisë së madhe të Konferencës së Londrës më 1913 dhe të Parisit më 1919-1920. Diplomacia e shekullit 21 kurrsesi nuk duhet të lejojë që në këtë pjesë të Evropës të ndizet zjarri i kohëve të kaluara, që nuk u shua krejtësisht që nga vitet e Kongresit të Berlinit e deri më 1999. Flaka e zjarrit të tillë mund t'i kalojë kufijtë e Kosovës dhe të Ballkanit e të përfshijë territore shumë më të gjera.

Pavarësia e Kosovës dhe bashkimi kombëtar shqiptar do të jenë garanci e fortë e paqes së qëndrueshme dhe e demokracisë së vërtetë në këto troje gjithmonë të trazuar.

Academician Mark Krasniqi

EXECUTION OF OVER 4 THOUSAND ALBANIANS IN THE PEJA
AND GJAKOVA VICINITIES

(On the Occasion of the 90th Anniversary of Montenegrin Genocide in Dukagjin)

Summary

We are marking today a day of mourning, a tragic year for our people of Dukagjini Plain, when 90 years ago the Montenegrin Army occupied our lands and committed terrible genocide against the innocent and unarmed civilian population, compelling them to change their religion and nationality and convert to the Orthodox faith and accept Serb-Slavic nationality. According to Slav sources, because of resisting conversion to the other faith, in the Peja and Gjakova vicinities over 4 thousand Albanians were killed with 800 others of the Plava and Gucia vicinities.

We are and remain grateful and indebted to our big and sincere friend – Democratic America, which saved us of Serb genocide, which saved our nation of annihilation, which was the aim of the century-old Serb-Montenegrin policy.

For an acceleration of NATO's intervention both the peaceful diplomatic resistance of over ten years, and the armed struggle of Kosovars for freedom and independence are equally deserving. We are also indebted to our big friend, Ambassador William Walker, who alarmed the Euro-American diplomacies in 1999 on the Serb terror and genocide against the Albanian people of Kosova.